

LIGJ
Nr.7544, datë 6.1.1992

PËR TATIMIN MBI FITIMIN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Fitimi vjetor nga veprimtaria ekonomike e personave juridikë vendas e të huaj i nënshtrohen tatimit.

Neni 2

Përgjegjësia për pagimin e tatimit mbi fitimin shtrihet nga dita e fillimit deri në ditën e mbarimit të veprimtarisë ekonomike.

Neni 3

Fitimi i tatueshëm, është fitimi vjetor që pasqyrohet në bilancin kontabël. Për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, normat maksimale të amortizimit caktohen nga Ministria e Financave.

Neni 4

Fitimi nga veprimtaria ekonomike e subjekteve vendas tatohet si vijon:

- Fitimi i personave juridikë shtetërorë 30 për qind.
- Fitimi i personave juridikë privatë përjashtohet nga fillimi i aktivitetit. Pas kësaj periudhe i nënshtrohet tatimit në masën 30 për qind.

Neni 5

Tatimi mbi fitimin e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe atyre me kapital plotësisht të huaj që ushtrojnë aktivitetin e tyre në nxjerrjen e burimeve minerare dhe energjetike, caktohet në masën 50 për qind.

Neni 6

Ndërmarrjet me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj ose me kapital plotësisht të huaj, që ushtrojnë veprimtari mbi 10 vjet, me përjashtim të atyre që përfshihen në nenin 5 të këtij ligji, paguajnë tatim mbi fitimin në masën 30 për qind, duke filluar nga viti i tretë i aktivitetit të tyre.

Për 3 vitet pasardhës u bëhet një zbritje 50 për qind të tatimit mbi fitimin.

Në rast se ndërmarrja me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj ose ajo me kapital plotësisht të huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, prish kontratën e lidhur sipas këtij neni, detyrohet të paguajë gjithë lehtësitë tatimore që ka përfituar deri në atë moment.

Neni 7

Humbjet që rezultojnë nga veprimtaria ekonomike gjatë vitit kalendarik, zbriten nga fitimi i

realizuar gjatë 3 viteve pasardhës.

E drejta e zbritjes së humbjeve nga fitimi i viteve të mëpasme humbet në rastin e shkrirjes ose riorganizimit të subjektit.

Neni 8

Personat juridikë ose fizikë të huaj, për pjesën e fitimit që transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, paguajnë një tatim 10 për qind mbi pjesën e fitimit të transferuar. Nga ky tatim përjashtohen personat juridikë a fizikë të huaj, që kanë lidhur kontrata për kërkimin e naftës a të gazit në det.

Neni 9

Personave juridikë e fizikë të huaj, që pjesën e tyre të fitimit e riinvestojnë, u bëhet një zbritje 40 për qind në tatimin e paguar për shumën e investuar. Këtë të drejtë nuk e përfitojnë ata që fitimin e mbajnë në formë depozitash.

Neni 10

Tatimpaguesit vendas dhe të huaj janë të detyruar të paraqesin deklaratë në organet tatimore të rretheve për fitimin e realizuar. Deklaratës i bashkëngjitet edhe llogaria vjetore për të ardhurat dhe shpenzimet.

Deklarata dhe llogaria vjetore për të ardhurat dhe shpenzimet plotësohen sipas modeleve që përcakton Ministria e Financave, dhe paraqiten në organet tatimore brenda datës 30 mars të vitit pasardhës.

Neni 11

Tatimi mbi fitimin derdhet çdo tremujor në buxhetin eshtetit në formë paradhënieje deri në datën 10 të muajitpasardhës. Subjektet juridikë a fizikë që krijohen gjatë vitit,tatimin e derdhin në varësi nga madhësia e fitimit që pritet tërealizohet. Rillogaritja për efekt të derdhjes së tatimit bëhetbrenda muajit mars të vitit pasardhës.

Neni 12

Quhen shkelje të këtij ligji:

- Fshehja e fitimit dhe e të ardhurave;
- Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve që përcaktojnë fitimin mbi të ardhurat;
- Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës së fitimit të realizuar dhe llogarisë vjetore për të ardhurat e shpenzimet;
- Mosrespektimi i afateve të derdhjes së tatimit.

Neni 13

Shkeljet e mësipërme, pavarësisht në se përbëjnë vepër penale dënohen edhe me këto masa administrative:

- Fshehja e fitimit dhe e të ardhurave si dhe falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve që përcaktojnë fitimin dhe të ardhurat, me gjobë në masën 5-fish të shumës së tatimit që rezulton nga llogaritja e fitimit të fshehur dhe me marrjen 100 për qind të tatimit të fshehur.
- Mosparaqitja në afat e deklaratës së fitimit dhe e llogarisë vjetore për të ardhurat e shpenzimet, me gjobë në masën 1000-3000 lekë.
- Mosrespektimi i afateve të derdhjes së tatimit, me gjobë në masën 6000-8000 lekë

Neni 14

Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e tatimeve në rrethe dhe punojnësit e drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të tij, përkatësisht te përgjegjësi i seksionit të financës a te drejtori i drejtorisë së tatimeve, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 15

Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 16

Dispozitat që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992.

Shpallur me dekretin nr.107, datë 11.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.